



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2382 Prot.

Tiranë, më 30.09 2025

VENDIM

Nr. 294 , Datë 24.09.2025

**“PËR PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË PËRSHPEJTUAR ME KËRKESË
PËR PROKURORIN FRANÇESK GANAJ”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 24.09.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar me kërkesë për prokurorin Françesk Ganaj”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2382 prot., datë 19.09.2025, të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, dëgjoi Relatorin, z. Moisi Duda, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli), garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, *“Për shpalljen e 18 (tetëmbëdhjetë) vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”*, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpalli 18 (tetëmbëdhjetë) vende vakante në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Elbasan, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Tiranë dhe Vlorë, të cilat do të plotësohen nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.
3. Gjatë këtij procesi u konstatua se 15 (pesëmbëdhjetë) prej kandidatëve, në momentin e aplikimit për këto lëvizje paralele, kanë paraqitur edhe kërkesë për vlerësim të përshpejtuar.
4. Me Vendimin nr. 65, datë 17.05.2024 *“Për miratimin e programit që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional me kërkesë për vlerësim të përshpejtuar të paraqitura në kuadër të procedurës së lëvizjes paralele për vendet vakante në prokuroritë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, shpallur me vendimin Nr. 13, datë 16.02.2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe caktimin me short e relatorit dhe këshilltarit përgjegjës për këto procedura vlerësimi”*, i ndryshuar, Këshilli ka filluar procesin e vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional për 14 (katërmëdhjetë) magjistratë. Pjesë e këtij procesi është dhe magjistrati Françesk Ganaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.
5. Me Vendimin nr. 66, datë 17.05.2024, *“Për caktimin me short të relatorit dhe këshilltarit ligjor përgjegjës për procedurat e vlerësimit të përshpejtuar të paraqitura me kërkesë në kuadër të procedurës së lëvizjes paralele për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, shpallur me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”*, të Këshillit, për vlerësimin me procedurë të përshpejtuar për prokurorin Françesk Ganaj u përzgjedh Relator z. Moisi Duda dhe Këshilltar përgjegjës për vlerësimin z. Olgert Rumnici.
6. Në bazë të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (në vijim, Ligji për Statusin), dhe nenit 17, të Vendimit nr. 95, datë 09.05.2022, *“Për miratimin e Rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”*, i ndryshuar (në vijim, Rregullorja), prokurorit Françesk Ganaj elektronikisht i është komunikuar fillimi i procedurës së vlerësimit dhe emrat e

Relatorit dhe Këshilltarit përgjegjës për vlerësimin, si dhe e drejta për të kërkuar përjashtimin e Relatorit dhe/ose Këshilltarit përgjegjës për vlerësimin.

7. Me e-mail Prokurori ka njoftuar se nuk ka konfliktin të interesave me Relatorin dhe Këshilltarin ligjor përgjegjës.
8. Përgjatë procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të prokurorit Françesk Ganaj janë administruar të dhëna dhe informacione nga Shkolla e Magjistraturës, ILD dhe ILDKPKI. Gjithashtu, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë janë administruar të dhënat statistikore të prokurorit Françesk Ganaj për vitin e vlerësimit 2023.
9. Në kohën kur procedura e vlerësimit të përshpejtuar për prokurorin Françesk Ganaj ishte në proces si më sipër, me Vendimin nr. 287, datë 17.09.2025 *“Për miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional për prokurorin Françesk Ganaj”*, Këshilli ka përfunduar procesin e vlerësimit etik dhe profesional periodik të prokurorit Françesk Ganaj duke e renditur me nivelin e vlerësimit *“Shkëlqyeshëm”*, në total me 394.5 pikë.
10. Në nenin 97, pika 1, të Ligjit për Statusin, citohet se:

...“Magjistrati vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur.”
11. Me përfundimin e vlerësimit etik dhe profesional si më sipër, vlerësimi i përshpejtuar me kërkesë për prokurorin Françesk Ganaj nuk mund të vazhdojë.
12. Në neni 8, të Rregullores *“Përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar”*, citohet se: *“Kur Këshilli vendos mbarimin e statusit të një prokurori, për veprimtarinë e të cilit ka filluar vlerësimi etik dhe profesional, deklarohet përfundimi i procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar...”*.
13. Në Ligjin për Statusin nuk rezulton asnjë parashikim tjetër në ligjin që parashikon situatën si më sipër. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale vlerësoi se duhet t’i referohet Kodit të Procedurave Administrative.
14. Në radhë të parë, përse i përket instituteve të anulimit apo të shfuqizimit, rezulton se neni 114, pika 1 e këtij Kodi, parashikon se: *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 108, të këtij Kodi, një akt administrativ i paligjshëm mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë”*. Siç rezulton nga ky parashikim, qëllimi kryesor është rivendosja e ligjshmërisë. Por kur Këshilli ka vendosur, kohë më

parë, që të fillojë procedurën e vlerësimit të përshpejtuar nuk ka pasur asnjë paligjshmëri.

15. Kodi i Procedurave Administrative lejon më tej, në raste përjashtimore anulimin apo shfuqizimin e akteve administrative të ligjshme, por nuk është vlerësuar se ndodhemi përpara këtyre raste. Kështu në nenin 115, të këtij kodi parashikohet se: *“Një akt administrativ i ligjshëm mund të anulohet, nëse pala në një akt administrativ që i nënshtrohet një detyrimi sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 102, të këtij Kodi, nuk e ka plotësuar tërësisht detyrimin apo nuk e ka bërë këtë brenda afatit të caktuar kohor”*.
16. Më tej neni 116, i këtij kodi, parashikon se: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike dhe kjo nuk mund të bëhet në mënyra tjera që cenojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të fituar të palës”*.
17. Siç rezulton nga përmbajtja e këtyre dispozitave, vlerësohet se Këshilli nuk ndodhet përballë asnjë prej këtyre rasteve përjashtimore. Pra, në përfundim nuk ekziston mundësia ligjore që ne të vendoset shfuqizimi apo anulimi i vendimmarrjes së Këshillit për këto raste.
18. Për këtë arsye, në këtë rast, mund të gjente zbatim parashikimi i nenit 95, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*.
19. Në rastin konkret, qëllimi pse u kërkua procedura e vlerësimit të përshpejtuar, ishte sepse magjistrati në fjalë, nuk kishte vlerësime të mëparshme. Në momentin që tashmë e ka këtë vlerësim, nga një tjetër procedurë, ajo e vlerësimit periodik, procedura e vlerësimit të përshpejtuar e ka humbur qëllimin e saj, pasi kjo magjistrate tashmë mund të kandidojë, duke pasur një vlerësim, atë periodik.
20. Ky argument duhet lidhur edhe me përmbajtjen e nenit 17 të Kodit të Procedurave Administrative, dispozitë e cila parashikon që: *“1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë. 2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë”*.
21. Në rastin konkret, duke qenë se asnjë prokuror në Shqipëri nuk ka dy vlerësime të nxjerra në bazë të Ligjit për Statusin, atëherë të gjithë prokurorët do të trajtohen në mënyrë të barabartë nga Këshilli, me qëllim që të jenë në kushte objektivisht të njëjta. Gjithashtu mund të argumentohet që nuk ka asnjë arsye të veçantë që prokurorët të

trajtohen ndryshe. Kjo qëndron në të njëjtën linjë, që mund të futet si argument, me vendimmarrjen e Këshillit për programin e vlerësimit për vitin 2025.

22. Në përfundim për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale i propozoi Këshillit, përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar me kërkesë për prokurorin Françesk Ganaj.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, pika 1, germa "a", të Kushtetutës, në nenet 91 dhe 97, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pikat 2 dhe 6, 189, pika 1, germa "a", dhe 192, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenet 95, 114-116, të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 95, datë 09.05.2022 "Për miratimin e Rregullores "Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve", e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të përfundojë pa vendim përfundimtar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar me kërkesë, për prokurorin Françesk Ganaj.
2. Të njoftohet për këtë vendim prokurori Françesk Ganaj.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e njoftimit të vendimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 24.09.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Zeqir Hoda

ZV/KRYETAR

Erind Gërmenji

ANËTAR

Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza



ANËTAR
Moisi Duda



ANËTAR
Olger Eminaj



ANËTAR
Erind Merkuri



ANËTAR
Erion Fejzulla



KOPJE WEB